

Të dashur prindër,

Në këtë udhëzues të shkurtër gjeni disa referues për t'u orientuar në brendësi të Spitalit e për shërbimet që ai ofron, duke bërë të mundur lehtësimin e qëndrimit të fëmijëve tuaj e duke ju shoqëruar përgjatë qëndrimit në Meyer. Harta dhe të dhënat që do të lexoni këtu duan t'ju drejtojnë përmes hapësirave të Spitalit dhe strukturave të tij. Dëshiroj t'ju kujtoj që mund të drejtoheni personelit: të gjithë profesionistët dhe punonjësit, të ndihmuar edhe nga vullnetaret, janë në dispozicion për çfarëdo kërkesë tuajën në lidhje me informacionet dhe orientimin.

Alberto Zanobini

1. Parkimi

Vend- parkimi i "Firenze- Parcheggio" në afërsi të Spitalit aplikon një tarifë ditore prej 4 euro, ekziston mundësia e abonimit për disa ditë qëndrimi.

Ata që kanë leje për persona me aftësi të kufizuar nuk paguajnë. As për motorët nuk paguhet.

Është i mundur edhe parkimi falas në vend-parkimin e rrugës Gore, 15 minuta me këmbë larg nga Spitali.

2. Pika e informacionit dhe portineria

Në katin e parë, ndodhet një zyre informacioni – URP (zyra e komunikimit me publikun) ku mund të merrni informacione mbi shërbimet, ambulatore, repartet, zyrat e ku mund të aktivizoni edhe kartën shëndetësore elektronike.

- nga e hëna deri të premten 8:00-17:00

Në qendër të sallonit (Hall Serra) është një vend-roje aktive

- 7 ditët e javës për 24 ore

3. Zyra e marrëdhënieve me publikun- URP

Është e mundur të kontaktoni punonjësit e URP-it, në hyrje, ku mund të merrni informacione mbi shërbimet dhe mundësitë që ofron Spitali; mund të merrni materiale informuese mbi nismat dhe shërbimet; mund të bisedoni e të kërkonin ndihmë në rast vështirësie për përfitimin e shërbimeve ose gjatë periudhës së shërimit; të paraqitni ankesa, të informoni e të propozoni.

- nga e hëna deri të premten 8:30-16:00
- **055 5662332** - urp@meyer.it - chat www.meyer.it/urp

4. Shërbimi social spitalor.

Punonjësit social janë prezent nga e hëna deri të premte nga ora 9:00 deri në 13:00. Shërbimi social spitalor ndodhet në hyrje të Spitalit. Për takime duhet t'ju drejtoheni personelit të strukturës ku ndodheni (reparti) o duke telefonuar numrin përkatës.

- **055 5662453** (është e mundur të lihet një mesazh në sekretarinë telefonike)

5. Sistemimi i familjeve

Me mbështetjen e Fondacionit të tij, Spitali Meyer ju ofron familjeve që kanë një fëmijë të shtruar mundësinë e sistemimit pranë strukturave të banimit të akredituara me Spitalin Meyer. Sistemimi në këto banesa është i përcaktuar nga shërbimi social në bazë të rregullores që parashikon respektimin e disa kriterëve, ndër të cilat repartin përkatës e kohëzgjatjen e shtrimit si dhe daljen nga Spitali me asistencë.

Për te përfituar nga ku shërbim mund të bëni një kërkesë personalisht, direkt tek shërbimi social apo te telefoni.

- Nga e hëna deri të premten 9:30-12:30
- **055 5662756** - servizioalloggi@meyer.it

6. Shërbimi psikologjik

Psikologët pediatër, të aktivizuar në të gjitha repartet, ofrojnë shërbim të specializuar fëmijëve, të rinjve si dhe familjareve të tyre që ndodhen në spital për një shtrim të zakonit në shtrim ditor apo në ambulator e po përballen me një sëmundje kronike në fazë akute

7. Ndërmjetësimi gjuhësor e kultural

Shërbimi i ndërmjetësimit gjuhësor e kultural është i pranishëm në spital sipas një orari të përcaktuar i disponueshëm pranë disa strukturave por mund të aktivizohet sipas kërkesës edhe në rast urgjencash. Bën përkthime dhe shërbime interpretimi orienton pacientët e huaj, redukton barrierat gjuhësore e kulture; ndihmon në marrëdhëniet mes të huajve dhe punonjësve

8. Kërkesa dhe tërheqja e dokumenteve shëndetësorë

Pranë zyrës së Pranimit n.1 mund të kërkohet kopja e dokumenteve shëndetësorë për kartelën klinike e cila do të jetë gatë brenda 30 ditëve nga data e kërkesës; mund të tërhiqet pranë Pranimit n.1 ose t'ju dërgohet me poste në shtëpi

- nga e hëna deri të premten 8:00-18:00; të shtunë e para festave 8:00-13:00
- **055 5662429** (hënë - premte 8:00-13:00) - fax **055 5662740**

9. Lokali, mensa dhe shpërndarësit automatik

Lokali është në katin e parë ku është e mundur të hani drekën dhe darkën.

- Çdo ditë 6:30-20:30
- 25 e 31 dhjetor, me 1 janar, për Pashkët e me 15 gusht nga 6:30-13:00

Në mensë ahahet me pagesë dhe është e lejueshme drekë e darkë për shoqëruesin e parë të një fëmijë të shtruar në spital

- Nga e hëna deri te premten 11:45-15:00 e 19:15-20:30
- të shtunën, të dielën e ditët e festave 12:00-14:00 e 19:15-20:30

Për familjaret e tjerë është e mundur të ahahet në mensë nga 14:00 deri 15:00 e nga 19:15 deri 20:30.

Pranë ashensorëve, përballë Pikës ku bëhen analizat e gjakut, në mes të sallonit të madh dhe pranë sallës së lojërave janë te pranishëm shpërndarës automatik të pijeve të ftohta e të ngrohta si dhe të diçka je për të ngrënë të ëmbël apo të kripur.

Në spital është e mundur të gjeni pije dhe ushqime pa glutina e pa laktozë.

10. Lactarium – Latte di mamma (Qumështi i nënës)

Nënat që ushqejnë fëmijën me qumësht gjirit mund të përdorin qumësht-thithësen e Lactarium-it. Lactarium grumbullon, trajton e konservon edhe qumështin e dhuruar të cilin ua shpërndan falas fëmijëve që kanë nevojë, në bazë të udhëzimit mjekësor. Lactarium është në katin e parë dhe është i hapur çdo ditë nga ora 11.00-18.40.

"Latte di mamma" është dhoma ku nënat e fëmijëve të shtruar në repartet e terapisë intensive, sub-intensive dhe reanimacionit mund të tërheqin qumështin e gjirit.

11. Aktivitete të lojë-terapisë

Të vetëdijshëm mbi rëndësinë që kurave mjekësorë t'ju bashkëngjiten kura dhe përkujdesje të dedikuara të vegjëlvë të shtruar, në spitalin Meyer mirëpritja e fëmijëve dhe familjeve të tyre në strukturat e shtrimit dhe ato ambulatorial është e mbështetur nga aktivitete të loje-terapisë; prezenca e kafshëve të "pet therapy", të klown-ve e të muzikantëve.

Oraret e prezencës së animatorëve profesionist janë të shënuar në tabelën e lajmërimeve në çdo



12. Salla e lojërave

Salla e lojërave është një hapësirë e mbushur me lojëra, libra e materiale për laboratorë kreative, që lejon kështu fëmijët dhe familjarët e tyre të kalojnë një moment argëtimi e pushimi gjatë shtimit në spital. Edukatorët profesioniste që menaxhojnë sallën e lojërave zhvillojnë, në bashkëpunim me vullnetarët, aktivitetet e tyre në mënyrë të vazhdueshme direkt në dhomat e atyre pacientëve që nuk mund të dalin nga reparti.

Salla e lojërave ndodhet në katin e tretë dhe është e hapur çdo ditë;

- nga e hëna deri të premten 8:15-13:00 e 14:00-18:15
- të shtunën 8:15-13:00 e 14:00-16:15
- të dielën 9:00-13:00

13. Biblioteka

Biblioteka ndodhet sipër sallës së lojërave nënçati. Shërbimi parashikon dhënie e librave hua e konsultimin e tyre, leximin e daljen e zakonshme përgjatë reparteve me një karrel me libra; menaxhohet nga vullnetarët

- të mërkurën, të premten e të shtunën 9:30-12:30
- nga e hëna deri të premten 15:30-18:30

14. Shkolla në spital

Fëmijët dhe adoleshentët e shtruar në spital mund të përfitojnë nga shkolla në spital që, në marrëveshje me institutin shkollor nga i cili vjen pacienti, ofron një kurs të personalizuar për të gjitha nivelet në mënyrë që të garantohet vazhdimësia arsimore. Mësimet mund të zhvillohen në dhomë apo në klasë brenda spitalit.

Në spital është aktiv edhe projekti "Vij edhe unë"; i menaxhuar nga vullnetarë, i cili ofron mbështetje arsimore vëllezërve të pacientëve të shtruar për kohë të gjatë të cilët nuk kanë mundësi të ndjekin mësimet rregullisht në shkollë

- **055 5662829**

15. Hapësira shpirtërore

Hapësira dedikuar shpirtit ndodhet në bodrum. Është gjithmonë e hapur sepse ka lindur pikërisht për t'ju ofruar të gjithëve mundësinë që të mund të luten në një vend të posaçëm

16. Kultet fetare

Spitali kujdeset dhe favorizon liritë fetare duke respektuar çdo besim e prejardhje fetare, duke i njohur çdo njërit dëshirën ose nevojën për të gjetur momente lutjeje e ndihme shpirtërore. Sipas kërkesës, personeli i repartit angazhohet deri sa familja hyn në kontakt me komunitetin fetar përkatës.

17. Shoqatat vullnetare e kujdestaria

Secila shoqatë dallohet për aktivitetin që kryen: priten dhe mbështetjen e të shtruarve dhe familjeve të tyre; praninë e përditshme në dhomat e vizitave e në shumë reparte; në mbështetje të personelit të Urgjencave; ndihmë e mbështetje për familjet e të miturve 24 ore rresht (shërbimi aktivizohet nga reparti pas vlerësimit që bën shërbimi social); aktivitete zbavitëse e krijuese; aktivitete në mbrojtje të drejtave, ndihma e nevojshme në evidentimin dhe sinjalizimin e tyre.

18. Shoqatat dhe fondacionet e prindërve

Shoqatat dhe fondacionet e prindërve dedikojnë aktivitetin e tyre ndihmës, mbështetjes dhe asistimit të fëmijëve dhe familjeve të tyre. Secila shoqatë ndërhyr sipas specifikës dhe patologjisë të cilës i është dedikuar. Shoqatat, që bashkëpunojnë të koordinuara, ndërhyjnë edhe për të orientuar të sëmurët e familjet e tyre në drejtim të kërkimit të një asistence, e të ndërhyrjes së kooperimit ndërkombëtar.

19. Dyqan- Libraria

Në katin e parë ndodhet një pikë shitje librash, gazetash, disqesh (DVD) dhe revistash gjithashtu është e mundur të blihen edhe bileta autobusi (ATAF) e materiale për nevoja të shpejta (Higjienike, furça dhëmbësh, biberon etj.)

- çdo ditë nga 7:30-19:30
- **055 4377553**

20. Bankomati

Sporteli i Bankomatit gjendet në sallonin e madh (Hall serra) në dispozicion të klientëve

21. Interneti Wi-Fi dhe telefoni publik

Spitali është i mbuluar nga rrjeti Wi-Fi falas për të kërkuar në internet. Në Spital ndodhen dy telefona publik: njëri ndodhet në hyrje të Urgjencës dhe tjetri tek hyrja e Radiologjisë.

22. Hapësirat e jashtme

Spitali Meyer është i rrethuar nga një park i madh i cili është në dispozicion të fëmijëve dhe të rriturve që i shoqërojnë. Parku është i pajisur me stola e tavolina aty ndodhet edhe Kopshti i Cice (Giardino di Cice), një hapësirë e kompletuar për të luajtur. Spitali Meyer ka gjithashtu një kopsht të ndërtuar në tarracën e sallës së lojërave, ku fëmijët, së bashku me prindërit e tyre, mund të marrin pjesë në mbjelljen, në kultivimin dhe në grumbullimin e bimëve aromatike dhe frutave të stinës.

23. Ndalimi i duhanit

Spitali Meyer është plotësisht i lire nga duhani. Ndalohet pirja e duhanit edhe në hapësirat e jashtme: në park, në kopsht, në tarraca, në rrugica e në afërsi të çezmave.

Vetëm në hapësirat e përcaktuara është e mundur pirja e duhanit.

24. Fondacioni i Spitalit pediatrik Meyer

Fondacioni i Spitalit Meyer ndihmon spitalin duke e mbështetur në kërkimin shkencor, zhvillimin klinik dhe teknologjik, në aktivitetin e lojë-terapisë në ndihmën e mirëpritjen e familjeve.

Në hyrje te Spitalit Meyer është zyra e dhurimeve ku është e mundur të dhuroni në favor të Meyer-it e të gjeni "gadget" institucionali.

- Nga e hëna deri të premte 9:00-17:30; të shtunë 9:00-13:00
- **055 5662316** - www.fondazionemeyer.it

KU NDOHET SPITALI MEYER

Spitali Meyer lidhet me qendrën e FIRENZE-s dhe stacionet hekurudhore kryesore nga:

autobus – ndalesa Spitali i Ri Meyer

treni – stacioni Firenze Rifredi e stacioni Firenze Santa Maria Novella

taxi - 055 4242 – 055 4390

Realizuar në bashkëpunim me Komitetin pjesëmarrjes të ndërmarrjes – Botim i prillit 2016

Ndërmarrja Spitalore-Universitare Meyer

rruga Gaetano Pieraccini, 24 - 50139 Firenze

telefon **055 56621**

PEC meyer@postacert.toscana.it - www.meyer.it

